

## KRASITJA E GJELBER

**Krasitja e gjelber;** Tani eshte periudha e krasitjes se gjelber, ajo eshte nje operacion i nevojshem per peme sepe heq deget e teperta, eliminon shperthimet ne peme, shendeteson peme dhe rregullon ekilibrin rritje prodhim. Sipas zhvillimit vegjetaiv dhe prodhimt te pemes ajo vazhdon deri ne vjeljen e prodhimt ....

### Kur behet krasitja e gjelber?

- Kur pema ka shperthime te medha dhe pemetari futet ne rrethin vicioz me peme "pre dhe shperthe".
- Kur duam te bejme formimin e kurores se pemes

### Ku aplikohet

- Aplikohet tek molla, dardha, kumbulla, qershia etj.
- Perdoret ne pemetoret intensive dhe ekstensive.


### Koha e kryerjes

- Eshte 10 Qershor-20 Korrik (kur lastari ka arrit drunjezim e plote ne baze) ne varesi te zonave te ndryshme klimatike, por vazhdon deri pas vjeljes se frutit sipas gjendjes se pemes dhe vendimit te krasitesit.
- Tek molla fillon kur gjatesia e lastarit ka arritur ne 14 -16 gjethe.

### Teknika e krasitjes:

Zbatohen te njejtat parime si ne krasitjen dimerore:

- Hiqen deget llupese ose thithaket
- Heqen e deget me kend te ngushte dhe drejtim vertikal,
- Nuk pincohen majat e degeve
- Lihen deget me kend normal (te gjere) qe sherbejne per formim kurore dhe prodhimin e ardheshem



Prerja e lastarit behet **me dy sytha ose ne pjesen unazore te bazes se lastarit.**

### Efekti

- Eleminon deget e teperta (thithaket)
- Kufizon shperthimet e reja
- Ekuiliber te pemes-rritje prodhim
- Shendeteson peme dhe perballon nevojat fiziologjike:
  - o veteushqimin, rritjen e frutave dhe pergatitjen per prodhimin e ardheshem
- Dritezohet dhe ajroset me mire pema
- Lehteson sherbimet ne peme te trajtimet dhe vjeljen
- Thjeshteson shume krasitjen dimerore.

### Rendesia ekonomike

- Rritet rendimenti dhe marrim prodhim te perviteshem
- Rritet cilesia e frutave
- Ulje e kosos se prodhimt

### Kujdes!

- Per varietetet qe kane rritje te fuqishme (Gala, Fuji) nuk duhet te behen prerje te medha sepe japin shume shperthime, por duhet te behet perkulja e degeve.
- Lastaret qe mbrojne frutat nga djegia diellore hiqen ne vjeshte ose pas vjeljes